

Nr. 3372. Prot
Data 17.07.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

- Sec. Këshillit Bashkiak
- Dr. Jani
- Sec. Regjistrimit

Durrës, më 15.07.2025

Nr. ~~476~~ prot.
14

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

SHIJAK

KRYETARIT TË BASHKISË

SHIJAK

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Shijak Nr.24 datë 01.07.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.112 datë 07.12.2020,"Mbi miratimin e listës (progresive) të familjarëve për përfitimin sipas programit të granteve tërindërtimit dhe projektet model".

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" (neni 8/a) i ndryshuar "Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore".

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3033 / 5 Prot

Shijak, më 02 .07.2025

VENDIM NR 24 DATË 01.07.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR 112 DATË 07.12.2020
“MBI MIRATIMIN E LISTËS (PROGRESIVE) TË FAMILJARËVE PËR PËRFITIMIN
SIPAS PROGRAMIT TË GRANTEVE TË RINDËRTIMIT DHE PROJEKTET
MODEL”**

Këshilli i Bashkisë Shijak në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Aktit Normativ Nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Vendimit Nr.5 datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendimit nr.282, date 09.04.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model’”, Vendimit Nr.879, datë 11.11.2020 “Për një ndryshim në vendimin nr.5, datë 06.01.2020 të Këshillit të Ministrave”, dhe pas kërkesave të familjarëve,

VENDOSI:

- 1.Miratimin e listës (progresive) të familjarëve të cilët janë përfitues sipas procesit të rindërtimit dhe kanë paraqitur kërkesat për përfitim nga programi i grantit të rindërtimit dhe projektit model .
- 2.Lista bashkëlidhur këtij projekt-vendimi me nr rendor 13.
- 3.Ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Ekonomike, në Bashkinë Shijak, për zbatimin e këtij vendimi.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI
Sulejman Toła

